



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagradi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "3PEZ L.L.C." të datës 05.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e **bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "3PEZ L.L.C." të datës 05.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti konfraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korrigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palet e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "3PEZ L.L.C." (tutje "parashtruesi") me datë 05.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistonjë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

"Kerkesa 9: 9. Katër (4) skelist. Të dëshmohet me kopje te diplomës se shkollës së mesme dhe trajnim të nevojshëm për skelist. Stafi i angazhuar në shërbime duhet të posedoj certifikata mjekësore për punë në lartësi sipas standardit ISO 45001. Në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit, dëshirojmë të paraqesim këtë kërkesë për ndryshim të dosjes së tenderit, konkretisht për heqjen e kërkësës që punëtori i skelevë të jetë i certifikuar me standardin ISO 45001 për punë në lartësi, e cila është përfshirë në dokumentet e tenderit. Duke u bazuar në Legjislacionin për Siguri dhe Shëndet në Punë në Republikën e Kosovës, dhe në veçanti në: Ligjin nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2013 për Sigurinë dhe Shëndetin gjatë Punës në Lartësi, theksojmë se nuk ekziston kërkesë ligjore që punëtori i skelevë të posedoje certifikim ISO 45001 për të kryer punë në lartësi. Ky standard është një sistem menaxhimi për organizatat, dhe jo certifikim individual për punëtorë. ISO 45001 është i aplikueshëm në nivel organizativ dhe synon përmirësimin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë në ndërmarrje, por nuk është as kusht ligjor, as praktik i zbatueshëm për individët si punëtorët e skelevë. Për më tepër, kualifikimi i punëtorëve për punë në lartësi në Kosovë rregullohet me kërkesat për trajnime të posaçme dhe dëshmi të kualifikimit përkatës, siç janë: Trajnimet për punë certifikuara nga subjektet e licencuara, Dëshmi të aftësisë profesionale të njoitura nga organet kompetente, Kontrolli mjekësor i rregullt i punëtorëve për punë. Përfshirja e një kërkese për certifikim ISO 45001 për punëtorë individualë është e pabazuar në kuptimin teknik dhe juridik, dhe përbën një pengesë të panevojshme konkurruese për operatorët ekonomikë, duke kufizuar pjesëmarrjen pa ndonjë arsyе objektive. Në këtë kontekst, kërkojmë me respekt: Të bëhet ndryshimi përkatës në dosjen e tenderit duke larguar kërkësen për certifikim ISO 45001 për punëtorët e skelevë, dhe të mbetet si kërkesë në përpunthje me udhëzimet administrative dhe ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës. Kerkesa 1 dhe 6: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në vlerë jo më pak se 75,000.00 € 6. Referenca të shërbimeve të natyrës së njëjtë (minimum një referencë), duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit nga shfrytëzuesi i fundit (të dëshmohet me kontrate të realizuar me raport të pranimit të punës ose referencë). Në dosjen e tenderit janë dhënë dy kërkesa të ndryshme (kërkesa 1 dhe kërkesa 6) të cilat të dyja kërkojnë kontrata të natyrës së ngashme dhe dëshmi për përvojë të mëparshme. Ne konsiderojmë që këto dy kërkesa janë për të njëtin qëllim dhe mund të konsiderohen si të mbivendosura, duke krijuar një barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë. Në këtë kontekst, kërkojmë me respekt qe duke pasur parasysh natyren e punës se kesaj procedure prokurimi; Të bëhet ndryshimi përkatës në dosjen e tenderit: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë largim te materialeve qe permbytje azbest në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në vlerë jo më pak se 75,000.00 € Kerkesa 2 dhe 3: 2. Operatori ekonomik duhet te kete pelqim mijedisor per Grumbullimin, Ndarjen, Trajtimin e Meturinave të Nertimit dhe Rrënojave nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastruktures opo nga Komuna 3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj deponi ose vend stacionim të përkohshëm për materiale me permbytje azbest ose mbetjeve të materialeve ndërtimore, në territorin e komunës se Prishtinës ose marrëveshje me deponi vend stacionim të përkohshëm. Deponia duhet të posedoj leje komunale për deponim te përkohshëm të azbestit. Kërkesa 3 mbivendoset me Kërkësen 2 e cila kërkon pëlqim mijedisor për

Faqe 2 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave ndërtimore, që në vetvete përfshin edhe detyrimet ligjore për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme siç është azbesti. Sipas parimit të proporcionalitetit dhe shmangies së kritereve të panevojshme kufizuese në prokurim publik, konsiderojmë se Kërkesa 3: • është e tepërt për kualifikimin teknik, Kërkjmë që kjo kërkesë të rishqyrtohet dhe të largohet ose të lejohet plotësimi alternativ përmes pëlqimit mjedisor nga Ministria ose Komuna në përputhje me legjisacionin në fuqi. Kërkesa 11: 11. Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune, i certifikuar për punë në lokalitetet me azbest. Ju njoftojmë se, sipas dokumentacionit të tenderit, objekti i kontratës lidhet me largimin e lesenitit me përbajtje të azbestit nga kulmet e objekteve, që përfshin punë ndërtimore dhe largim të mbetjeve të rrezikshme, pa përfshirë punime apo ndërhyrje në sistemin elektrik. Për këtë arsy, konsiderojmë se kërkesa për një inxhinier të elektrikes është jo-relevante dhe joproporcionale, dhe bie ndesh me nenin 53.7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton që kriteret për kualifikim duhet të janë të lidhura drejtëpërdrejt me objektin e kontratës dhe të janë proporcionale me natyrën e saj. Kërkjmë rishqyrtimin dhe eliminimin e kësaj kërkesë, ose sqarim mbi nevojën reale të përfshirjes së një inxhinieri elektrik në një projekt që përfshin vetëm largim fizik të materialit ndërtimor(lessonitit) nga kulmet e objekteve".

Lidhur me pretendimet ankimore, është gjetur se kërkesat për stafin profesional duke përfshirë kërkesat për skelist dhe inxhinier të elektrikes por edhe kërkesat për referencat, qarkullimin dhe pëlqimet mjedisore, të gjitha së bashku dhe secila një nga një duhet të rishqyrtohen pasi që si të tilla dhe në mënyrën se si janë formuluar aktualisht nuk janë të domosdoshme për realizimin me sukses të projektit prandaj mund të përbëjnë kufizim të konkurrencës potenciale në mes të operatorëve ekonomik. Prandaj pretendimet janë gjetur si të bazuara. Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik". Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtuesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënët më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.08.2025

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 3 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net